

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME ELEZ NIKÇIN

Prishtinë | Data: 1 gusht, 2023

Kohëzgjatja: 63 minuta

Të pranishëm:

- Elez Nikçi (I Intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Latra Demaçi (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Elez nëse mundeni me u prezentu, me na tregu vitin e lindjes, vendin, diçka për kujtimet e juja të hershme të fëmijërisë?

Elez Nikçi: Elez Nikçi nga Shtupeqi i Madh, i lindur më 18.10.1953 në një familje malësorësh nga babai Mala, nga nana Havë. E cila nana Havë osht' mesa e Ruzhdi Selmanit, heroit. Nga baba jem osht' Veseli, nga ana tjetër luftëtar, pjesëtar i të gjitha luftërave ndaj pushtuesve e okupatorëve të asaj kohe, të periudhës 1900 e knej. Jom rritë ni familje malësorësh. Shkollën fillore e kom kry në vendlindje, pjesën e parë, domethonë, katër vjeçare. Tetë nuk ka pasë.

Pjesën tjetër jemi, kemi pasë fatin që kemi pasë axhën të arsimum. Axha im ka qenë viteve '50-ta, jurist. Ka qenë, ka kry shkollën juridike në Prishtinë edhe ai ka qenë marrëdhënie pune në Pejë. Kështu që e kemi pasë ni mundësi me ra në Pejë te axha që me fillu pjesën e dytë, tash po i thojnë shkolla e mesme, pjesa e dytë e tetë vjeçares. E kom kry Shkollën Fillore "8 Marsi" në Pejë.

Pastaj, u regjistrova në shkollën normale në Pejë po atëherë ka qenë ni, ni, ni zhvillim i jashtëzakonshëm i arsimit. Se viteve '66- '67 u ndrru ni sistem totalitar ndaj Kosovës. Se deri atëherë ka qenë ni administrim totalitar ushtarak. Me ramjen e atij personi famkeq, i qujtun [Aleksandër] Rankoviç, atëherë u hapën disa dyer të kulturës e të arsimit në Kosovë. Kështu që patëm rastin me bo ni evolim të arsimit.

Pastaj pas regjistrimit fillova nja dy javë erdh ni konkurs i shpallur për artist për shkollim në shkollën e baletit në Shkup. Si i ri babën e kisha bujk, nuk dike çka osht' ajo. Shkova te axha e pyta, "A bon m'u regjistru?" M'tha, "A po ke dëshirë?" "Po". Edhe kështu që pata fatin n'mesin e shumë dashamirëve që kanë qenë për t'shkuar në atë shkollë pata fatin t'zgjedhem, të jem në mesin e tyre, të atyre 25 vetave që kemi shku në Shkup.

Anita Susuri: Paraprakisht po du me ju pytë se dikund e kom lexu që edhe në familje keni pasë trashëgimi vallëzimin...

Elez Nikçi: Tashti axha, njëkohësisht po flasim për axhën i cili ka qenë i arsimum, mirëpo ai në '47-ten e ka themelua Ansamblin Folklorik "Rugova". Edhe për nga ajo ditë na si familje kanë marrë pjesë të gjithë kanë marrë pjesë axha, baba, axhallarët tjerë, nana jeme, motra, vëllau... tani Vesel Nikçi e udhëheq Ansamblin "Rugova" si trashëgimtar i axhës.

Nga kemi pasë, domethonë, rugovasit, malësorët gjithmonë e kanë pasë tradicionale edhe ato festat kur kanë qenë, qofshin ato pagane, qofshin ato islame kanë pasë vallëzimin. Janë mbledhë t'ritë e t'rejat edhe kanë vallëzu. Kështu që nuk osht' veç edhe familja jonë po si regjion e kanë trashëgimi vallën, kangën edhe vallën.

Anita Susuri: E ky ansambël që e ka formu axhi, a ka funksionu kështu totalisht si ansambël a ka qenë diçka amatore?

Elez Nikçi: Jo, ansambël amator prej, prej '47-tes e deri ditët e sotit kurrë pa ndërpre. Gjatë kohës së okupimit gjithmonë janë angazhu njerëzit për me, me e mbajtë gjallë atë ansambël që mos me pasë pauza fare. Ni periudhë ka qenë qatëherë vitet '97-'98 kur ishte ofenziva e madhe, qaty pak nifar'... po 2000 e knena tani ka vazhdu me ni trend të jashtëzakonshëm.

Anita Susuri: A keni shku në ndonji objekt me ushtru apo si ka qenë kjo?

Elez Nikçi: Atëherë në atë kohë, folëm për Ansamblin "Rugova" apo? Unë nuk kam qenë pjesë e Ansambilit "Rugova", nuk kom qenë. Por, ata kanë ushtru deri viteve kur osht' bo mundësia, viteve '70-ta kanë ushtru nëpër shpija ose nëpër livadhe. Ashtu edhe osht' mbajtë. Mirëpo ai shquhet ansambël autokton sepse osht' burimor. Domethonë nuk ka përpunim n'ta, asnjë nuk preket, as koreografike as kurrfare. Domethonë osht' burimore ashtu qysh osht' trashëgimi brez pas brezit.

Anita Susuri: Për Vallën e Rugovës, po tash çfarë lloji tjetër t'valleve kanë mujtë me... a i kujtoni ju si fmi? A i keni pa si po vallëzojnë ata? Apo cilat valle janë?

Elez Nikçi: Ato zakonisht, zakonisht janë valle autoktone të cilat luhen nëpër ahengje të ndryshme, qofshin ato edhe të dasmave. Janë të ndryshme. Janë për shembull ka karakter e cila ka motivacion të luftës, me shpata. Domethonë, ni demonstrim të vallës të qëndrueshmërisë të një malësori në ato kohëra shumë të vështira edhe e paraqet atë bujarinë edhe atë krenarinë nëpërmjet vallës. Pastaj ka pasë edhe lirike, për shembull, ku lujnë ni vajzë e ni djalë. Është ajo lirike me tregue atë anën e lirikes që ekziston edhe ni pjesë tjetër, jo vetëm ajo luftarake.

Anita Susuri: Çfarë kujtime keni prej fëmijërisë? Si ka qenë me jetu në atë vend?

Elez Nikçi: Tashi, shumë vite domethonë po më bjen m'u kthy, dikund 60 vite prapa. Nuk ka qenë... Regjioni i Rugovës ka qenë një prej regjioneve ma të prapambetura në çdo pikëpamje të zhvillimit. Mos

t'foli për tjerat po në aspektin ekonomik ka qenë ni tmerr i jashtëzakonshëm. Sepse në viset malore te na pos elbit, asni gja s'bahet. Asni gja. As nuk ka grun, as kollomoq, as kurfar' misri, hiç, hiç, hiç. Pos elbit edhe kumpirat. Asni gja tjetër. Domethonë krejt jetojnë prej blegtorisë.

Pastaj nuk ka pasë infrastrukturë. '83-ten ish kryetari i kuvendit të asaj kohe, Ilaz Kurteshi, ka marrë iniciativë edhe e ka bo elektrifikimin në Rugovë. Domethonë deri n'atë kohë nuk ka ditë Rugova se çka osht' drita. Domethonë deri në '83-ten, llogarite kur osht' kjo kohë, kur osht' kjo periudhë. Domethonë ka qenë jetë shumë ma e vujshme, domethonë, po kanë mbijetuar.

Pastaj, ana arsimore shumë pak kem pasë njerëz të arsimum në Rugovë. Kanë qenë njerëzit ndryshe, prej gjithkahit kanë ardhë me dhanë mësim. Njo prej tyne për shembull ka qenë Daut Dermaku, që ma ka tregu ai vet, në disa fshatra që ka punu me vite ka punu. Domethonë ni njeri prej, vjen prej Drenice edhe e shtin në Rugovë nëpër male e pse infrastruktura... domethonë ka fjet nëpër shpija. Njerëzit e kanë majtë në shpi të vet mësusin. Ia kanë, me ia mësu fminë.

Kështu ka qenë ajo jeta jonë shumë e vështirë. Tani kohë pas kohe kanë ardhë t'u përmirësu gjanat. Viteve '80-ta pak ma shumë. U ngrit edhe ni shkollë tetë vjeçare në Drelaj edhe kështu që kanë funksionu pak ma mirë. Kuadrat tona janë zhvillu tanshi, janë arsimu, kanë mri m'u kthy atje në vendlindje me dhanë mësim edhe kështu ka ardhë deri te ajohja.

Anita Susuri: E përmendët infrastrukturën, po m'intereson edhe fshati për shembull, si kanë qenë shtëpitë? Shpija ku ju keni jetu, si kanë qenë të ndërtune? Apo oborret?

Elez Nikçi: Tashti na nuk kemi pasë, i thojnë, këta pjesa e rrafshit havale. Te na nuk ka ekzistu, te malësorët. Te malësorët nuk ekziston ajo fjalë as shprehja edhe as si objekt. Domethonë ka qenë i hapur. Ne e kemi pasë ni kullë guri, e marune prej guri. E mbaj mend, shumë i vogël jom kanë, kur janë mbledhë ata... se zakonisht kur e marojshin vijshin t'nimojshin. Domethonë vishin katunet e farefisit t'nimojshin ni ditë e dy e derisa e kemi ngritë.

E kemi ngritë, aty jemi rritë na në atë kullë. Fatkeqësisht ajo nuk ekziston ma se u rrënu pas lufte. Qashtu tanshi jemi rritë. Si familje e madhe jemi kanë, jemi kanë katër mixhollar. Kemi jetu s'bashku. Pos mixhës, mixha ma i madhi që ka qenë në Pejë atëherë me detyra të ndryshme tjetër kanë qenë dikush me dhen e dikush me qerre t'u bajtë lanë. E qishtu jeta jonë, jeta jonë e vështirë.

Pastaj, ka qenë, ka qenë te ajo koha periudha, se tash kjo ngrohja globale e ka bo të vetën. Veç atëherë kem pasë gjashtë muj dimër. Kur shtator ka ra borë deri në qershor nuk u hjekë bora. Domethonë ka pasë gjithmonë mbi ni metër borë.

Anita Susuri: Sa ka qenë e vështirë për juve me udhëtu deri dikund? Kur keni dashtë deri në qytet me dalë ose...

Elez Nikçi: Jo s'kemi udhëtu. Ka lind edhe ka dekë në Rugovë ai edhe Pejën s'e ka pa me sy kurrë, as s'ka ditë çka osht' Peja. Sepse nuk ka pasë infrastrukturë. Kjo vonë u çelë kjo rruga kanioni qitash që po thojnë. Këta e ka çelë Austro-Hungaria. Nuk ka pasë hiç kurrë, kambësore ka qenë, nëpër male. E na i thojmë rrugë kambësore, rrugë e kuajve, kurgjo ma shumë.

Anita Susuri: E ju personalisht çfarë moshe keni dalë e keni pa qytetin?

Elez Nikçi: Unë (qeshë), unë me gjyshen, se gjyshja ke mbetë e ve në moshën 25 vjeçare ju ka vra burri edhe i ka rritë jetima edhe shpesh kur bijke në Pejë, kisha qef, më merrke me veti. Domethonë udhëtonim, se fshati im 12 kilometra osht' prej Peje. Udhëtonim 12 kilometra teposhtë edhe 12 përpjetë në kamë, domethonë, qikjo osht ajo. Kisha qef me ra me ta po jo gjithherë po ndonjëherë, ni herë ose dy herë në muj me ra në Pejë.

Anita Susuri: A osht' burri i saj që thatë që ka qenë luftëtar?

Elez Nikçi: Jo, gjyshi. Gjyshi u vra, e baba i gjyshit, domethonë, veç baba jem e mixhollarët që po desin tash se te na krejt familja ma së shumti në moshën 25-24-30 vjeçare nuk kanë shku ma tutje.

Anita Susuri: E që e përmendet atë luftëtarin, a keni dëgju ndonjë rrëfim për to çfarë, me kond ka luftu?

Elez Nikçi: Tashti ai ka qenë pjesëmarrës i mbrojtjes, gjithmonë është mbrojtë kufini. Domethonë osht' mbrojtë kufini. Lufta ma e njoftun që osht' e Pazarit, që janë mbledhë krejt, na i thojmë bajrakçi. I kanë thanë n'atë kohë. Kanë marrë pjesë Drenica, Llapi kanë qenë, rrafshi kanë marrë pjesë në luftën e Pazarit. Domethonë me forca çetnike. Me forca çetnike. Pastaj ka qenë lufta e Nokshiqit quhet, lufta e Nokshiqit quhet. Mbrojtjen me forcat serbo-malazeze edhe qishtu. Qishtu ka qenë ajo. Gjithmonë t'vujtun, gjithmonë t'hjekun. Gjithmonë ka qenë pjesa e zonës kufitare ka qenë gjithmonë njerëzit ku kanë jetu aty, në veçanti rugovasit.

Anita Susuri: E thatë që osht' marrë shumica e popullsisë me blegtori, edhe familja juj osht' marrë...

Elez Nikçi: Absolutisht. Unë deri në moshën gjashtë vjeçare i kom rujtë bagëtinë, i kom rujt delet.

Anita Susuri: Sa ka qenë e vështirë për familjen e juj kur keni vendosë me shku në Shkup, a ka qenë edhe financiarisht e vështirë kjo apo?

Elez Nikçi: Jo, nuk ka qenë sepse ai ka qenë një, një vendim i Këshillit Ekzekutiv u qujtë përpara atëherë ka qenë qeveria e sotshme. Ka qenë Këshilli Ekzekutiv. E di që iniciatori kryesor ka qenë Azem Shkreli, ni njeri larg pamës. Azem Shkreli ka qenë iniciator po këtu i ka ndihmu edhe njëri më duket se prej

Prizrenit osht' ai, Xheladin Topxhiu. Ndoshta nuk jom i sigurt i kahit osht'. Veç këta dy edhe ish drejtori i televizorit Riza Alaj. Ai në atë kohë ka punu në Këshill Ekzekutiv.

Këta tre persona e kanë ngritë këtë çështje. Sepse ishin, që thashë, më parë zhvillimet e pas diktaturës të egër ndaj Kosovës ishin derë e hapur për zhvillimin e kulturës në veçanti. Se në atë kohë u hapë edhe në raportet kulturore Kosovë-Shqipëri, Kosovë-Shqipëri u hapën. Ai trend shkoj te njerëzit largpamës si ka qenë Azem Shkreli. Sepse pak a shumë opera veç ishte në themelim e sipër. Po ni subjekt shtetnor, ai subjekt shtetnor i aspektit kulturor është edhe baleti.

Ata kanë qenë, Azem Shkreli ka qenë larg pamës në këtë punë, me shoktë e vet jo veç vetëm, që duhet t'bohet edhe baleti. Pastaj shkoj edhe ma larg e boni edhe Kosova Filmin. Domethonë ni njeri që ka qenë ni atdhetar i jashtëzakonshëm, ni njeri intelektual i jashtëzakonshëm i cili ka mendu se çka duhet m'i bo ni shteti në të ardhmën se njerëzit kanë mendu edhe ma vonë që do të bohet. Kështu që iniciatori kryesor i baletit sotshëm që ekziston osht' Azem Shkreli.

Anita Susuri: Domethonë osht' hapë ni konkurs për të gjithë që janë të interesun me studiu baletin për m'u bo...

Elez Nikçi: Po tash, a din qysh, nuk munësh, e kem pasë kështu si shpallje e patën qit' n'derë. Tashi i qesin në koridore po atëherë s'kemi pasë asi tabele që po i qesin tash. Ni letër e kanë qit' me ato pullat *trruk* {onomotope}. E kemi pa të gjithë kush ka pasë dëshirë. Quhet ajo audicion, thirret audicion. Kemi marrë pjesë ajo, drejtoresha e shkollës të baletit, nuk muj me ia majtë mend emrin...

Anita Susuri: Në Shkup që ka qenë?

Elez Nikçi: Po, po. Ajo ka qenë, ajo ka qenë me nifar... memoria, kur t'len memoria... Ipka lvena ka qenë, ka qenë çeke ajo, ka qenë mësimdhanëse në shkollën e baletit në Shkup. Sepse shkollat e baletit në krejt Jugosllavinë i kanë majtë pjesa e lindjes, Çeki, Poloni, Rusi. Për shembull na e kemi pasë, na e kemi pasë prej Kijeve, atëherë ka qenë Kijeva ka qenë ruse. I kemi pasë dy profesor. Njanin e kemi pasë lojërat historike, njanin e kemi pasë lojërat karaktere. E di që kanë qenë rus. E kemi pasë njo Juri ka qenë.

Anita Susuri: Domethonë ka qenë ni grup ma i madh pastaj në audicione jeni përzgjedhë?

Elez Nikçi: Po, absolutisht. Ajo ka qenë, ka qenë ni kërkesë e jashtëzakonshme ka qenë, ka qenë shumë. Trendi e ka bo t'vetën. Se kqyre, njerëzit... sepse edhe ishin pak e lehtësune sepse investimin ta bojke ni mekanizëm shtetnor edhe kështu e kishim ni bursë. Me atë bursë jom shkollu edhe kështu që kom... pastaj kuptohet me mbarimin e shkollës kemi ardhë në Prishtinë. Kemi fillu me ni shfaqje t'hapjes atje, kemi marrë pjesë. Pastaj kemi vazhdu. Baleti i parë ishte i Akil Kocit, ka qenë... u dashtë

m'i shkru këto sene (qeshë). Baleti i parë, baleti i parë osht' i Akil Kocit, tash m'bjën ndërmend. Tani ni koreograf e patën marrë prej Sarajeve, e kemi ba.

Anita Susuri: E qysh ka qenë krejt eksperiencia në Shkup kur keni shku?

Elez Nikçi: Po tashi meqë i kishim ato kushtet tona na u vendosëm nëpër internate, domethonë, konvikte. Ishin konviktet banonim nëpër konvikte të shkollave të mesme. Tani prej atyhit shkojshim në shkollën e baletit. E kishim paradite, masdite. Kishim edhe pjesën tjetër të arsimit, vishin arsimtarët të Zef Lushmarkut, Gjimnazit Zef Lushmarkut. Vishin me na dhanë pjesët e gjuhës shqipe, gjuhë shqipe, historinë, gjeografinë këto a dinë për me kanë pak ma e kompletune. Se shkolla e baletit, nuk do t'thotë, osht' profesionale po nuk do t'thotë mos m'i msu edhe këto tjerat gjana. Edhe gjuha frenge. Ka qenë gjuha frenge se baleti dominon jo dominon po osht' i shkrun në gjuhën frënge terminologjia. Në krejt botën përdoret gjuha frënge.

Anita Susuri: E ushtrimet për shembull si kanë qenë?

Elez Nikçi: Po fillimi, a din qysh ishte, fillimi me vështirësi të jashtëzakonshme se duheshin ato pozicionet derisa t'msohet trupi për shembull m'i thy kamtë. Që i thojmë ato hapat e parë të baletit. Ka qenë, ka qenë po kur njeri mendon që ka shku në ni drejtim s'ka kthim prapa. Duhet t'ecësh përpara se tash qysh mujsha me bo ni arsyetim nëse e kisha lëshu shkollën e baletit m'u kthy, çka i kisha thanë unë babës, pse u ktheva. Kështu që gjithçka, gjitha sfidat u dufshe m'i përballu.

Anita Susuri: A ka pasë edhe, po mendoj, vajza sigurisht ka pasë po...

Elez Nikçi: Jo i kemi pasë vajzat, i kemi pasë. Njo të Pejës, dy të Prishtinës, njo të Gjakovës. Esmë ka qenë, Shqipja, Kumrije Hoxha, Zana Tafarshiku, qito kanë qenë. Katra kanë qenë vajza tjera jo. Tjerat s'kanë pasë marrë pjesë. Qito kanë marrë qito janë kanë të pranune. Këto pastaj... ne në mungesë të vajzave se krejt baletet kanë problem me mashkuj, na kishim problem me vajza. Kështu që tani pak a shumë u orientum me i marrë prej lindjes. I morëm prej Polonisë tani erdh edhe ni romune. Tani erdh edhe qajo e Filipineve edhe Maria Balta. Tani ato dyja anglezet, tri.

Kështu që... se baleti osht' botnore, e ka ni gjuhë. Nuk dallon pse osht' vështirësia. Vështirësia mundon vetëm te ana ekzekutive e koreografisë, aty tani hasim probleme. Sa ke aftësi. Se janë, janë disa elemente të cilat janë shumë të vështira s'mun i bon gjithkush. E janë ato *double, double* rrotullimi ose ato piruetat sillen ose mbajtja e balerinës me ni dorë, 70 kilogram e përpjetë.

Anita Susuri: E sa ju ka ra me qëndru, tri-katër vite në shkollë?

Elez Nikçi: Katër vite të plota. Shkolla e mesme e baletit, katër vite. Na e kemi kryesu se zakonisht osht' rregull kryhet shkolla e ultë e baletit katër vjet tani shkolla e mesme. Pa e kry të ulten në të

mesmen s'mun shkon. Po këtu, këtu na e kemi bo ni privilegj këtu te na në Prishtinë kur e kemi hapë degën e baletit në shkollë të muzikës me ndihmën e, me ndihmën e drejtorit për arsim të Komunës së Prishtinës, Zijadin Gashi.

Na... ai ka qenë edhe pak, jo pak po shumë ndihmës i madh me hapë shkollën. Me na plotësu qat' kërkesë tanën. E hapëm paralelen. Kështu që u hap, na vazhdum. Tashti janë këta pasardhësit tanë që tash nuk janë pasardhës po kanë bo goxha ni, 30 vjet po i bojnë në skenë nuk janë pak. Janë të shkëlqyeshëm, ndoshta i ke pa. Janë të shkëlqyeshëm shumë. Sidomos Jeta Musolli që e kom pasë nxanse timën. Jetën nxanse timen.

Anita Susuri: Po du me ju pytë edhe pak për jetën kulturore tashti në Shkup. A keni përcjellë ndonjë edhe ju vet ngjarjet kulturore atje apo jetën shoqërore siç ka qenë?

Elez Nikçi: Tashi çdo shfaqje që bohet atje, s'e kishim obligativ detyrues po obligativ dëshirues. Shkonim në opera edhe baletin që saherë shfaqjet që u mbajshin shkojshim atje. Shkojshim edhe në Teatrin e Kombësive. Ka qenë Teatri i Kombësive ku kom pasë rastin ta njoh edhe Jusuf Gërvallën. Ai ka qenë pëshpëritës. Quhet pëshpëritës quhet ai sufleri që i pëshpërit fjalët ngadalë aktorit m'i marrë, ka qenë aty.

E mbaj mend Muharrem Qena e bojke ni shfaqje e ky ka qenë aty. Se ka pasë punu Isufi edhe në "Flakën e Vllaznimit". A u qujtë qashtu m'duket, "Flaka e Vllaznimit" m'duket qashtu u qujtë ajo gazeta në Shkup. Ka qenë redaktor në atë gazetë. Shkojshim edhe në teatër i kqyrshim shfaqjet edhe shqip aty. Në teatrin, qashtu osht' qujtë, Teatri i Kombësive.

Anita Susuri: A mundeni me ma përshkru për shembull si ka qenë atëherë me shku në teatër? Po m'duket edhe janë rregullu njerëzit ma shumë kanë pasë ni veshja ma të veçantë?

Elez Nikçi: (qeshë) Mundësitë tona kanë qenë qashtu. Qato çka i ke pasë. S'kem pasë mundësi na t'kemi veshje e kësi diçka t'veçanta sikur sot që kemi me u veshë me krevatë, me setër jo. Vajzat u veshqin pak ma mirë, pak, kishin pak mundësi se vajzat... se atje kur shkojshim në ushtrime nuk ki çka ti që t'qitësh shminkë ose të lyhesh se i pengon, gjatë ndjersitjes ajo të hin në sy t'pengon pastaj.

E mirë, kemi kalu bukur shumë. Tash shumë vite janë atje po kemi kalu mirë. Jemi kanë shumë kompakt. Qajo kompaktësi e atjeshit na ka majtë edhe 40 vjet masanena në Prishtinë. Qashtu kemi qenë bashkë. S'kem ditë kurrë m'u përta, s'kem ditë kurrë me folë ni fjalë t'keqe njani tjetrit. Kurrë, hiç, hiç, hiç deri jena dalë në penzion, kurrë hiç.

Anita Susuri: A janë ata 25 ende...

Elez Nikçi: Gjysa janë, gjysa nuk janë ma. Nuk osht' as drejtori, nuk osht' ma as ai kolega, as ai stolisti i parë, Rrustem Selca s'osht' ma, qishtu. Edhe Esmë ajo balerina edhe ajo nuk osht' ma. Kështu që vjet e bojnë të vetën.

Anita Susuri: Po m'intereson tash këtu kur keni ardhë në Prishtinë, qysh osht' organizu ose si...

Elez Nikçi: "Sokoli edhe Mirusha", baleti i parë.

Anita Susuri: Si osht' organizu ajo për shembull? Përgatitja?

Elez Nikçi: Tashti me ardhjen tonë në Prishtinë për shembull e ke, Azem Shkreli e ka ditë që ekziston edhe dikush ni balerin i yni që ka punu bashkë me njerin ma të madhin balerin në botë, Rudolf Nurejevin, ka qenë Abdurrahmon Nokshiqi, Abi. I cilin e ka thirrë, në atë kohë ka qenë t'u punu në Operën e Berlinit, edhe e ka thirrë edhe ka ardhë tani në Prishtinë. Ata e kanë emëru si koordinator. Na e kemi qujtë shef të baletit.

Se, pra në teatër kemi ekzistim tri njësi punuese. Ka qenë drama shqipe, drama serbe dhe baleti. Domethanë trijat e kanë pasë kah ni shef. Na e kem pasë Abin, Abdurrahmon Nokshiqi. Tanshi ai e ka pasë për obligim me bo koordinimin e shfaqjeve, bashkë me këshillin artistik. Domethonë ka qenë këshilli artistik se, pra, në teatër janë kanë këshilli artistik i cili e ka ba programin vjetor të shfaqjeve ose për shembull të premierave.

Tashi kur osht' ardhë puna me bo qit' baletin të Akil Kocit, "Sokoli dhe Mirusha", për shembull kanë ra në kontakt me Akil Kocin kompozitorin. E kanë thirrë, kanë bisedu me to. Librin thojnë e ka bo vet ai. Tanshi e kanë thirrë, kond me marrë, kanë ra në kontakt me Sarajevën edhe e kanë marrë koreografin nga Sarajeva edhe e kanë pru në Prishtinë. Kemi fillu ushtrimet edhe e kemi qit' premierën, atëherë, "Sokoli dhe Mirusha". Unë e kom lujtë Mimçin, roli i dytë ka qenë. Sokolin e ka lujtë, kolega jem Rrustem Sellca.

Anita Susuri: A i keni pasë kushtet e mira në fillim për ushtrime për shembull?

Elez Nikçi: As atëherë as sot. Fatkeqësia ma e madhe, as sot. Kërkund s'e kom mendu unë që 20 vjet pas lufte nuk e marojmë ni teatër. Me m'pa thanë dikush, andërr me pa pa kisha thanë jo bre ishalla jom jerëm. Po qe, është realitet. Kemi ushtru kah mos, kah mos kemi ushtru. S'kemi ushtru kaniherë gati dy vjet, s'kemi pasë ku ushtrujmë. Kem ushtru foaje, foaje thirret ajo para se me hy në teatër, beton.

Në balet për ushtrime osht' ni pod special i cili ka ni nivelacion prej pesë centimetrave. E jo ti me ra me, prej nalti me zbrit poshtë pa ni amortizim të dyshemes, me ra me kocka. Se dëmtimi bohet i nyjeve. Nuk kem pasë. Kem ushtru, në Boro Ramiz kemi ushtru, në Pallat të Rinisë kem ushtru. Kemi

ushtru në Bashkësi Lokale qitu te Bahollt ku e kanë servisën, qaty kemi ushtru katër vjet a pesë a dhjetë a.

Anita Susuri: Sa orë n'ditë keni ushtru?

Elez Nikçi: Tash kjo njona obligative osht' ushtrime trupore thirren, ushtrime trupore klasike. Domethonë mbajtja e kondicionit edhe teknikës. Ato kanë qenë obligative ni orë e gjysë. Pastaj kemi pushu pak ia kem nisë programi i shfaqjeve. Domethonë kush çka e ka pasë rolin. Gjithmonë peshën kryesore e kanë pasë rolet kryesore, domethonë, ata e kanë pasë me ushtru ma së shumti. Tani kemi shku në pushim në mesditë. Ia kemi fillu tani masdite prej orës 04:00 deri në ora 08:00 në mramje. Kështu, qishtu shkon.

Se artisti, arti në përgjithësi edhe baleti edhe opera edhe drama nuk e kanë orar të caktun, punon tetë orë shkon në shpi. Nuk ka orar të caktun hiç. Mesditës, ka pasë për shembull kur e kem përgatitë baletin "Halili e Hajria" që ju dha mundësia me ardhë koreografët nga Shqipëria. I madhi Panajot Kanaçi erdh me Pëllumb Agalliu i cili tash Pëllumb Agalliu osht' drejtor i baletit të Azerbejxhanit.

Ganimete, Ganimetja Terbeshi me Haxhën edhe Ganimetja kanë qenë të shpallur në atë kohë prej Enver Hoxhës heroinë e punës socialiste. Domethonë nivelin ma të lartë të artistikës që e kanë pasë. Se ata e kanë me gradime, jo si na që s'kem gradime fare. Te na dita e sotit nuk kanë gradime, nuk kanë gradime. Tash vetit ia kanë bo ligjin me gradime, me shkallë sa osht' 17, 18, 19. Baleti, sektori artistik s'ka gradime fare.

Anita Susuri: Qysh ka qenë me bashkëpunu prej Shqipnisë që kanë ardhë ata?

Elez Nikçi: Knaqësi ma të madhe... baleti nuk njeh kufi, thashë, mirëpo knaqësia ma e madhe ka qenë na me vu në skenë ni balet kombëtar ni "Halil Hajria" ni legjendë e jona. Sigurisht se e kuptoni, atëherë n'atë kohë, ajo pjesa e periudhës otomane në Shkodër që ka ndodhë. Ajo pabesia që ia kanë bo Halilit, ia ka bo motra e vet. Tashi me i vu në skenë ata. Kemi ushtru tre muj ditë, tre muj pa ndërpre, domethonë, tre muj s'ka pasë pushim fare as paradite as masdite. Tre muj të plota. Me thanë që kom ardhë në 65 kilogram ti ide nuk ki. E kom pasë rolin kryesor të Halilit. 65 kilogram kom ardhë.

Anita Susuri: Duhet shumë angazhim.

Elez Nikçi: Unë thashë osht' ajo... baleti, baleti e ka beneficues stazhin. Meqenëse ky lloj beneficimi ma s'po ekzistojke as në polici as kërkund. Domethonë baleti e ka 12 mujshin 18 mujsh, ni vjet ni vit e gjysë numërohet stazhi. Për nga pesha e randë që e ka si minatori. Domethonë minatorët e kanë qashtu edhe na e kemi pasë. Policia e ka 14 muj, jo, 16 muj policia. Tash s'e kanë as policia, as baleti, as kurgjo s'e kanë këtë beneficion.

Anita Susuri: Po m'intereson edhe diçka, atë ditë që ka shfaqje, çfarë përgatitje trupore duhet me pasë? Ju për shembull si jeni përgatitë? Për nga ushqimi, pushimi?

Elez Nikçi: E, po ti kishe pasë t'ardhurat e mira domethonë ushqim kishe zgjedhë, na kemi hongër pasul (qeshë). Pasul, lakna. U konë ni gjelltoe e bojshin do qaty karshi kuvendit n'anë t'kundërt anena u kanë ni gjelltoe. Qaty shkojshim hajshim, shkojshim n'banesë flejshim. Ni banesë me katër kreveta qaty flejshim me vite t'tana. Derisa jom martu. Edhe kur jom martu kom nejt edhe pesë vjet pa banesë, pa kurgjo. Domethonë 15 vjet unë si solist i parë i baletit, unë s'kom pasë kulm mbi kokë, s'kom pasë kulm mbi kokë. Po shqyr pastaj u rregullun gjanat.

Anita Susuri: Po m'intereson edhe kështu në shoqni edhe në rreth ju si, se atëherë ka pasë shumë, domethonë veç ju keni qenë grup i baletit, nuk ka pasë tjerë. Si jeni pritë ju prej njerëzve tjerë? Rrethit t'juj?

Elez Nikçi: Valla me ta thanë të drejtën fillimi ka qenë shumë i vështirë se ka qenë skeptik sepse thojshin me atë shprehjen pak popullore, "Ku deshët burri lakuriq". Se kur nuk e ke të zhvillun, vitet e para si shtetet e tjera... pak kanë qenë skeptik mirëpo me kohën. S'ka kalu shumë, me thanë, nuk kanë kalu dy vjet edhe kanë kuptu që me t'vërtetë osht' art i bukur edhe plot skena u mushte, plot.

Artisti për shembull e ka atë ndjenjën e vet, kur e shef, për shembull, se na zakonisht e çelshim pak me kqyrë {shpjegon me gjeste që largon pak perdën} a ka publik. Kur e shihshim plot sallën, zemra mal na u bojke. S'mendojshim a kem bukë me hangër ma. Atë knaqësinë ma të madhe... se ushqim, arti ushqim osht'. Arti osht' ushqim, të ushqen. Me kanë t'u dekë uni, arti t'mush plot. Arti ushqim. Kemi kalu mirë, kemi pasë plot ku kemi shku me shfaqje tona.

Zakonisht, zakonisht na i kemi pasë shfaqjet tona autoktone. Pak kem marrë... na kemi marrë vetëm baletin "Kopilia". Osht' ni, ni balet që e ka ba ni, ni artist i Beogradit edhe e kemi bo na. Osht' balet i mirë me përmasa botërore. Na e kemi ba. Atje e kom lujt rolin kryesor, Kopiliusin. Koreografe ka qenë nifar' prima balerina e Beogradit Vishnja Gjorgjeviq e cila s'jeton ma. Ajo kur pat' ardhë në Prishtinë shumë me skepticizëm ka ardhë. Veç kur i shihke në qytet vajzat tona të gjata, të bukura thojke, "Jo", thojke, "unë ktu për dhetë vjet i kisha ba pesë balette i kisha bo prej ktyne vajzave", (qeshë).

Anita Susuri: Qysh ka qenë edhe kjo jeta në qytet në Prishtinë në atë kohë?

Elez Nikçi: Nuk ka qenë e natës. Ka qenë në fakt diskoteka, unë i kom urrejt me dalë n'atë kohë. Edhe si i ri i kom urrejt, nuk jom shku. Nuk kom shku. Jo që i urrej pse ekzistojnë, formën e sjelljes brenda diskotekës nuk m'pëlqen, s'më ka pëlqy atëherë as sot s'më pëlqen.

Anita Susuri: Ju keni pasë disiplinë shumë ndoshta?

Elez Nikçi: Po kqyre, varet edhe prej karakterit të njeriut. Unë kom pasë kolegë të mi që kanë shku, kanë shku nëpër diskoteka kanë nejt po nuk ka zgjatë shumë sepse ka qenë e kufizune edhe atëherë. Në 12:00 osht' mbyllë edhe diskoteka, nuk ka funksionu pas 12:00-ve. Zakonisht jeta jonë ka qenë korza në Prishtinë. Kemi dalë qaty kemi shëtitë pak. Janë kanë do breja janë konë, që i kanë hjekë tash, janë konë u bojshim tub qaty rrishim deri kah ora 09:00, 10:00-tshi nuk na gjejke në qytet. Veç po thom, ka qenë e shëndoshë, në atë aspektin po foli... jo tash, nashta tash, tash koha e ka bo të vetën, mos t'hi në gjyna me rininë (qeshë) se tash dalin në 12:00. Na në ora 10:00 njeri ti nuk gjojshe në qytet, hiç, hiç, hiç, njeri.

Anita Susuri: A ka qenë kjo koha edhe kur jeni njoftu me bashkëshorten?

Elez Nikçi: Po. Ajo kohë ka qenë. Zakonisht qashtu jemi njoftu niherë, t'u shëtitë qaty, shok mas shokut e qishtu.

Anita Susuri: A ka qenë studente ajo apo?

Elez Nikçi: Jo, ka qenë nxanëse e shkollës të mesme. E mashtrova (qeshë). Ja bojsha kësaj vajzës të vogël, Nitës, "M'ka mashtru nani me karamelle", deke t'u keshë (qeshë).

Anita Susuri: E thatë që pastaj...

Elez Nikçi: Ka qenë sportiste gruja jem, ka qenë kampione e Kosovës pesë vjet. Dhjetë vjet ka qenë në ping pong, ka qenë dhjetë vjet. Tanshi me sporte u marrë vetëm çika e vogël. Tani kjo dhetë vjet ka qenë kampione e Kosovës në karate. Tash çikat e veta i ka msu atje në Amerikë, osht' kampione e Amerikës ju ka bo çika e madhe, Nina. Osht' anëtarësu tash në stacionin e Amerikës. I ka 12 vjet.

Anita Susuri: Shumë mirë. Po m'intereson edhe kështu a keni udhëtu jashtë Kosovës me mbajtë shfaqje?

Elez Nikçi: Jo, jashtë Kosove s'i shtet jashtë Kosove si krahinë. Si krahinë po kemi shku. Kemi shku në Novi Sad, në Beograd, kemi shku në Lublanë. Çdo natë u mbajshin, quheshin bienalet e baletit, u qujshin ato takime të baletit të ish Jugosllavisë. Saherë na kena shku atje kena shku me baletet tona autoktone. Ia patëm me ni formë ia kena imponu edhe atyne që edhe ata me u marrë me diçka, po s'kishin, s'kanë, nuk kanë, nuk kanë të kaluar historike që të kanë ata balete t'vete, nuk e kishin. Na e kishim, na kishim edhe kompozitor tanë i kishim.

Për shembull, "Motivet Kosovare", i kemi bo, "Kangët e Rexhës", osht' ba, "Kush e solli Doruntinën", Korbin e kom lujtë une. Bile kemi pasë marrë se në lojrat verore të Dubrovnikut me marrë pjesë ka qenë problem i madh. Atje shkojshin veç ekskluziv. Teatër edhe të baletit na kemi marrë pjesë. Na

baleti kemi marrë pjesë në kështjellen atje, në kështjellen në Kalanë e Dubrovnikut e kemi dhanë shfaqjen.

Anita Susuri: Cila shfaqje ka qenë?

Elez Nikçi: “Kush e solli Doruntinën”.

Anita Susuri: A osht’...

Elez Nikçi: Absolutisht. Ajo ka qenë e hapur, kuptohet, janë të hapura ato për shembull atje. Osht’ skena s’ia shihshe fundin sa ka. Se shumë ka pasë edhe t’huju. E qishtu. Mirë kemi kalu. Tani u mbajshin festivalet atje, kemi marrë pjesë. Ni shfaqje na hoqi nuk na lanë me shku atje, “Vallen Pranverore”. të Gazmend Zajmit.

Anita Susuri: Pse?

Elez Nikçi: Sepse Gazmend Zajmi ishte rektor i universitetit edhe ishte nënshkruesi i petitionit, nënshkruesi i petitionit për që institucionet tona që ke edhe, “Vallja Pranverore” mendojshin ata që koincidon me demonstratat e ‘81-tes edhe ish rektor i universitetit. Na anulun, nuk na lanë me shku. U tutshin çka po ndodhë me filmin e Agim Sopit, “Heroit të Mjegullës”.

Pjesa e Dytë

Elez Nikçi: ‘90-ta ishin t’u përgatitë ni shfaqje të Azem Shkrelit, “Liberto”, e pat’ bo Azemi. Na t’u e bo edhe kemi pasë vallahi edhe nja dy javë me qit’ premierën. Tani hijnë masat e dhunshme, masat e dhunshme hijnë në Kosovë. Hijnë në televizion. Se me pushtimin e televizionit kishte marrë fund gjithçka. Tanshi na e obligun qata me ba, na obligun qata me ba. Qat’ baletin i qujtun “Banoviq Strahinja” me motive të Luftës të Kosovës¹. Që s’kishin të bëjnë fare me atë punë. Mirëpo me gjetë ata ni arsye t’jem, me arsyetim që s’po dojnë këta me veprue edhe, edhe na e hoqën.

Pastaj na lëshun vendimin, kur na hoqën prej pune, na çun vendimin, vendimin t’përrjashtun prej pune të mos respektimit të instancave federative. Demek të asaj kohe. Pastaj kishim ndër shumë sepse atëherë askush prej neve në Kosovë nuk pranonte ni diktat të imponun. As na nuk e pranum edhe dolëm n’rrugë, tanë. Tanshi, dikush anej dikush kërkah e dikush kurgjo. Jeta ishte ma e vështirë shumë.

¹ Beteja e Kosovës u zhvillua në rrethinë të Prishtinës, Kosova (Dardanise) në vitin 1389 midis Serbisë (ndërmjet një koalicioni ballkanik), dhe Perandorisë Osmane.

Ma i kisha, isha dy fmi. E kisha qit' vajzën Emën që osht' tash në Asamble Komunale në Prishtinë. Djalë e kisha, të voglin s'e kisha hala. Me çka? Rrogë jo, gruja n'punë jo, unë n'punë jo, kështu ka qenë ajo jeta jonë. Mirëpo uni nuk jemi dekë, jemi gjind. Kem shku për shembull, unë fatin e kisha pak ma mirë se kolegët e mi sepse e kisha axhën në Gjermani edhe shkojsha në Gjermani atje punojsha ni muj, dy muj u kthejsha kha. Me qato tani e përballojsha deri vitin e ardhshëm. Kështu ka qenë.

Anita Susuri: E qysh ka ndodhë që u bonët pastaj truproje? Në cilin vit?

Elez Nikçi: E tashi, e tashi, ajo periudhë ka qenë n'viteve '90-ta. E mori ni, ni, ni rezistencë u formu, ni rezistencë popullore ndaj ni okupimi totalitar. Ata 280 intelektual që nënshkruan atë petitionin fillojnë tani organizimi i gjithëmarshëm edhe n'atë organizim gjithkush kish qef me dhanë kontributin e vet. Thënë ndryshe, unë e kisha pak njoftësi me Ilirin, Ilir Shaqirin. Sepse paraprakisht kangën e tina, "Fjalët e qiririt", ia kishim përpunu me Rustem Sellca ni koreografi që nuk u bo kurrë ma. E pat' inçizuri ky Gani Vërdemaj.

Ai shkante shpesh shkante në shoqatë aty edhe ni ditë prej ditësh i thom... edhe ai Çun Lajçi me to. I thom, "Thuj bre qatina, qatij Adnan a si e ka emrin, t'vi qaty veç t'boj diçka, te di që po boj diçka, jo kumeditë çka", qishte ka qenë. Pastaj Adnani m'ka marrë i cilit i falënderona shumë. Jo pse m'ka marrë n'punë, i falënderohna shumë për mbështetjen që ma ka dhanë gjithë kohën edhe mbasanena edhe kur ai shkoj e ma la mu pozitën e tina, shefit të sigurimit. Ni falënderim t'jashtëzakonshëm i jepi atina sepse ka qenë ni njeri i cili i ka qëndru kryetarit [Ibrahim Rugova] bash n'mnyrën ma të mirë të mundshme. Ndoshta unë s'kom mujtë me bo çka ka bo ai, po jom përpjekë.

Kështu që ka ndodhë me u inkuadru aty viteve '90-ta deri '99-ten, 2000-ten. Domethonë '99-ten unë kom qëndru në Kosovë, nuk kom dalë jashtë, kom qëndru në Kosovë. Bile ni periudhë, ni periudhë ka qenë prilli, prilli ka qenë valla m'duket prilli, edhe kam shku në Velani. Në qat' rrëmujë kom shku në Velani. U vasha, shkova te kryetari thashë pa shku s'e la. Shkova deri aty, bile këtë shkumjen time e ka përmend kryetari edhe në Hagë kur ka qenë. Sepse i thanë ata, ia bonën ni pyetje që nuk ka qarkullu kërkush. Ata morën unë që kam shku. Sepse nuk kishin mundësi me thanë jo sepse mu m'kishin nalë policia para dere aty, s'më lanë me hy mrena hiç.

Qishte unë nuk kom dalë jashtë. Kanë qenë periudha shumë të vështira. Masanena Adnani, Adnani e mbylli kapitullin e vet, ashtu qysh e ka thanë në televizion, ni dhjetë vjeçar të punës tina. Atë detyrë e mora une. Mirëpo kalova pastaj nëpër shumë sfida. Sfidat të pakëndshme të cilat s'ia kisha dëshirë kërkujna. Sfidat që, një ka qenë të parashikume, të paparamendume, të tmerrume. E në veçanti bomba kur osht' qit aty eksplozivi i veturës prapa teatrit. Ka qenë ndjenjë, s'kisha përjetu kurrë ni tmerr aq të madh brenda veturës.

Anita Susuri: Kur ka qenë kjo?

Elez Nikçi: 2000, kur u ardhë Solana, 2004-ten m'duket, 2005. Mas luftime, mas luftime. Po thom, mas luftime domethonë po foli për pjesën kur e kom marrë unë prej Adnanit. Domethonë u konë që jom ballafaqu me gjanat ma t'vështira t'mundshme, ma t'vështira t'mundshme...

Anita Susuri: Po m'interesojnë vitet e '90-ta, ka pasë shumë ngjarje historike që kanë ndodhë. Me ardhjen e delegacionet e para prej Amerikës, që osht' formu edhe zyra amerikane ktu. Domethonë n'atë kohë Presidenti Rugova ka qenë n'krye t'politikës me thanë, domethonë, i cili osht' marrë me kto delegacione gjithmonë. Po ju si, domethonë, si pjesë e krejt ksaj, çka keni pa? Qysh e keni përjetu?

Elez Nikçi: Po tash nuk e kisha unë atë pozicionin, atë pozicion e ka pasë Adnan Merovci, mirëpo kam qenë aty afër. Unë kom qenë gjithmonë aty sepse isha pjesë e asajna strukture. Ka qenë, ka qenë ni zhvillim i jashtëzakonshëm, ni trend i zhvillimit i mbështetjes faktikisht. Sepse për pa të mbështet ni mekanizëm ndërkombëtar veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ti s'munësh me ecë përpara. Me mbështetjen e tyre që ia patën dhanë kohë ma përpara, tanshi ai veprimet s'i ka nalë kurrë, nuk i ka nalë kurrë.

Tashti me i tregu Europës, në veçanti Serbisë që këtu osht' Amerika, qashtu e kom kuptu unë nashta nuk osht' qashtu. E themelun zyrën amerikane këtu, ku po i bjen tanshi, qe meniherë këtu në anën e majt meniherë {bën me dorën e majt} mi urë u çelë zyra amerikane. Se me çelë ni zyre ose me kanë unë e kuptoj që i ka thanë që këtu osht' Amerika ma, këtu osht' Amerika. Ajo tanshi edhe ma shumë i fuqizoj popullatën, ju dha shpresë popullatës që ni ditë do të jemi ku jemi. Mirëpo shkoj goxha larg, pa dëshirën tonë po shkoj goxha larg. Mundime, tortura të njerëzve, rrehje, burgosje, vrasje besa-besë e kështu me radhë.

Tanshi ni formë u detyru edhe me dalë publikisht kryetari me thanë, "Pragu i shpisë mbrohet gjithsesi". Domethonë ajo nënkuptonte që duhet organizu edhe ushtarakisht. Sepse ai me thanë në mënyrë decidive nuk e thanë sepse e kishte rrugën paqësore të cilën e kanë mbështetë amerikanët. E tash nuk mujke me hangër me dy lugë. Po e tha në fund, tha, "Pragu i shpisë mbrohet me gjithçka", domethonë na dha mundësinë me bo organizime tjetër, e cila edhe u ba. Pastaj u ba, u themelu Ushtria Çlirimtare e Kosovës. U themelunë organet tona shtetërore, policore.

Pastaj u burgosën, u burgosën Destan Thaçi, u burgos Avdi Memetoviçi ka qenë kryesori shefi i policisë e shumë tjerë u burgosën e, do ikën torturave. Kështu që ka qenë periudhë e jashtëzakonshme e vështirë edhe e vështirë po edhe e kandshme. Sa e kandshme ka qenë edhe e vështirë. Sepse gjithçka u dufshe me kuptu që çdo veprim që e bojshe ti në kundërshtim me aparaturën shtetërore ti u dufshe me ditë që ki me has në pengesa. Tashti i kishe parasysh edhe ato, tashi varësisht kush qëllojke, dikush ma shumë e dikush ma pak e. Mirëpo në qoftëse nuk të vrasin apet dhimbja kalojke, të rreshin kalojke. Qishtu.

Anita Susuri: E ju bash keni qenë në rrethin e Ibrahim Rugovës si truproje e tij, a ka qenë e rrezikshme për juve? A jeni përcjellë apo a keni pasë ndonjëherë problem?

Elez Nikçi: Tashi, tashi mas luftime kanë ekzistuar shumë forma të ndryshme të presionit, mas luftime. Po folim tash mas luftime, domethonë pas 2000-tes po foli. Ka qenë presion ndryshe. Tash me formimin e strukturave të ndryshme, të dëshirave të njerëzve... se tashi nuk mundësh me kanë shumë i sigurt ata a ka pasë dorë këtu edhe forcat ndërkombëtare apo kanë pasë veç vendore. Se po e zam, po ta marr shembull 2000-ten, Xhemajl Mustafa, ma kanë plagos grujen në Dardani. Tashti plagosja e sajna, se kohë ma përpara e kanë malltretu edhe fizikisht kështu.

Forma të ndryshme. I kanë shku dy vet, njo te dera, njo... punonte në ni zyre të kompjuterave qaty në Ulpianë. Ajo formë ka qenë e presionit që unë ta lëshoj atë pozicion ose t'i frikësoj tjerët që t'mos merrën. Ose vrasjet, për shembull, me ia vra, shembull, njo mrapa e kanë vra pastaj e kanë vra Xhemajl Mustafën. A Xhemajl Mustafa ditën që ia kanë plagos grujen të nesrit ka shku në shpi e ka vizitu. Kërkush nuk ka shku pos Xhemajl Mustafës. Edhe i ka thanë, "Me ty e kanë kry, i ka ardhë reni tjetër kujt". Tash sot me grujen teme pikë e ka atë fjalë t'tina edhe s'ka shku java e kanë vra.

Domethonë, vrasjen e Xhemajlit e kanë bo me i frikësu tjerët, "Mos u merrni me atë njeri ma, leni vetëm". Mirëpo nuk e lanë vetëm. Kështu që as unë me do dhim të temën në familjen time nuk e kom lanë punën po kom vazhdu tutje. Pak ma parë t'thashë, u dashtë me qenë i ballafaqun me të gjitha sfidat edhe t'brendshme edhe të jashtme. Tashti dorën n'zemër s'muj me thanë që kush e ka ba atë akt, as për ata as për këta. Sepse çdo thanje me ia thanë atij është e pa logjikshme kur nuk ke argumente. Domethonë argumenti nuk po flitet sepse nuk janë dalë argumente kurrë s'janë dalë, për asni vrasje.

Pos Ukë Bytyçi që e ka vra kryetari i kryesisë të Degës të PDK-së në Suharekë, i ka vra Ukë Bytyçin me dy udhëtar. I vetmi person që u dit kush e ka vra osht' Ukë Bytyçi, tjerët nuk dihet. As ata, as Tahir Zemën, as Smajl Hajdarin, as Ismet Racin. Domethonë janë vra njerëzit e nuk dihet kush. Tashi unë s'muj me thanë që e kanë vra as ata as ata, po janë vra ata, për ni motiv po. E motivi kryesor ka qenë me ia vra bashkëpunëtorët e Ibrahim Rugovës që me lanë vetëm. Tash kush e ka vra këtë nuk e di, nuk muj me thanë. Veç kështu kanë qenë ato sfidat që thashë ma herët.

U duft me ditë unë që kur kom shku me marrë qat' detyrë i kom thanë vetit, "Ke shku ti edhe kthim mrapa s'ka. E ke marrë atë detyrë edhe duhesh me ecë përpara, me t'gjitha sfidat duhet me u ballafaqu". A me paramendu që shkojnë në qat' masë, me qit' eksplozivin me ta kthy kerrin në krah të pesë tonave, të blindun me kthy, osht' tmerr i zotit, tmerr.

Anita Susuri: A u lendu najkush aty?

Elez Nikçi: Jo s'munët me lëndu se munët me lëndu vetëm nga ekspozimi me të plasë, me ta zanë gojën e mbyllur të pëlcet kapilarët në tru. Po fati ynë nashta në ato momente tanë e kemi pasë gojën çelë. Jemi kanë në veturën e blindune me vozitësin Qefser Baholli edhe une ngat tina, Skender Hyseni edhe kryetari [Ibrahim Rugova] në kerr. Tash në ato momente nashta e kemi pasë gojën çelë edhe kemi shpëtue.

Anita Susuri: Po m'intereson edhe vitet e '90-ta, a keni përcjellë Ibrahim Rugovën kur ka qenë edhe jashtë?

Elez Nikçi: Jo, jo. Viteve '90-ta ka qenë tjetër strukturë. Viteve të '90-ta ka qenë Adnani me ni ekipë tjetër. Me Agim Ademin, e kuptoni kush osht'? Kryetari i federatës të futbollit, Agim Ademi. Imer Rama, janë kanë Muharrem Rama, janë kanë këta njerëz të cilët... Afrim Gashi, Mentor Zeqiri tash osht' në Zyrën Amerikane, punon përcjellës në Zyrën Amerikane. E këta janë kanë ata ekipi, të jashtëzakonshëm. Po thom, djem të jashtëzakonshëm kanë qenë. Tash pas luftës tani u ndrru struktura. Ata dikush e kish gjetë tjetër rrugë e dikush tjetër rrugë.

E formum ni tjetër ekipë. Ekipa u formu pak me vështirëse sepse hezitonin me ardhë, me ta thanë të drejtën hezitonin pak me ardhë njerëzit. Tashi nuk munësh m'i thanë kujna pse po heziton. Po ni fatbardhësi e jashtëzakonshme ka qenë që vëllau i ktyne i madhi, Halil Geci, ka ardhë te kryetari naltë aty edhe i ka thanë, as s'e ka vet Elezin as Adnanin. U shku i ka thanë kryetarit, "Unë pesë djem ka me t'i pru prej Drenice". Ai ka qenë, ka qenë ai shtylla kryesore e atij segmeti domethonë, e asaj mbrojtjes të afërm ka qenë ni shtyllë, ni shtyllë me shtyllë graniti. Atë e ka bo Halili.

Dy vjet ua ka pagu rrugën djemve që kanë udhëtu prej atjehit viteve të 2000-ta. Kështu që u formu qajo ekipë pastaj. Janë ardhë pesë ata. Unë kom qenë, i kom pasë edhe dy-tre punëtorë tjerë veç jemi bo ni ekipë e dhetë vetave përcjellje e afërt. Duhej me u bo edhe ni njësi tjetër në mbrojtjen e objektit si objekt, duhej me tri ndrrime. Nuk ka qenë bash lehtë, nuk ka qenë bash lehtë. Domethonë edhe në aspektin financiar nuk kishte, domethonë ka qenë vullnetar, s'kishe kurgjo. Mas luftime sen s'ke pasë hiç.

Anita Susuri: E para luftës çfarë aktivitete tjera keni pasë vitet e '90-ta, me çka jeni marrë tjetër?

Elez Nikçi: Para se me punu në presidencë?

Anita Susuri: Po de, vitet e '90-ta.

Elez Nikçi: Vitet e '90-ta unë ma s'di tjetër gja veç që kom shku qatje që thashë te axha kom punu e jom kthy e kom majtë familjen. Nuk kom mendu me lëshu Kosovën fare. Meqenëse mas plagosjes të gruas patën ardhë Zyra Amerikane me marrë familjen me çua... qikjo çika e madhe që kom ka thanë, "Jo s'pranoj me lanë babën këtu".

Anita Susuri: E gruja juj në cilin vit u plagos?

Elez Nikçi: Në të 2000-ten. Ni javë pa u vra Xhema. Tani pata hjekë keq vallahi me shëru, nja pesë vjet me shëru prej traumës.

Anita Susuri: Po m'intereson në luftë thatë që keni qenë në Prishtinë, si ka qenë përjetimi juj?

Elez Nikçi: Tmerr. Tmerr. Nuk përshkruhet që nuk sheh mizë, nuk sheh bubrecc rrugëve të Prishtinës. Nuk sheh sorrë, zog nuk sheh. Unë qito sene domethonë, ni vdekje klinike e gjithçkaje. Në Dardani kom jetu qaty, e kom pasë te kurrizi, në katin e tetë. Qaty çka s'kom pa. Veç s'kisha me çka me inxhizue çka kom pa në atë udhëkryq. Çfarë malltretimi u bojshin policia civile, krejt me armë. Qiky djali që p'e përmend në Dardani që u kanë me ni djalë nifar' Deniqit në uniforma. Qaty civila... qiky që ke ministër çka dreqi u bo që patën thanë... patën bo nifar' problemi kta të Vetëvendosjes, Rikallo a qysh e pat' emrin ai...

Anita Susuri: Aha, po, po, po.

Elez Nikçi: I kom pa me sy t'mi. Me automata në rrugë qaty. Jo t'u i vra njerëzit veç t'u i malltretu, a t'u i vra jo. Veç i ndajshin.

Anita Susuri: E kur kanë fillu bombardimet?

Elez Nikçi: Qaty jom kanë, qaty.

Anita Susuri: Qysh e keni përjetu?

Elez Nikçi: Çka me t'thanë, po bojke njeri... interesant po t'hiqke tuta, nuk po kishe frikë. Na ra qaty, ni pjesë e rakës ra mrapa ndërtesës tonë. U kanë ni kafe "Tane" knojshin serbisht, qaty u majshin organizimet, qaty i bajshin armët i shkepshin në polici civile qata në Dardani. E ra në oborr qaty. E çikën e kom pasë ni dhomë tjetër po djalin qysh e ka gjetë prej krevetit në tokë e ka qit' në Dardani. U thyn xhama, u thyn dritare krejt. Tmerr ka qenë, tmerr!

Anita Susuri: A kanë ardhë juve me ju largu juve prej banesës ose diçka?

Elez Nikçi: Jo, nuk janë ardhë, po s'kom dalë. Thjeshtë nuk kom dalë sepse mendojsha ai presidenti osht' në Velani, unë me dalë me ikë s'ma bajke, s'kom mujtë me dalë.

Anita Susuri: A keni shku, thatë në prill keni...

Elez Nikçi: Valla nuk e kuptoj, nuk e di mirë se s’i kom shënu a dinë, se s’e kom ditë që duhen ato dikur (qeshë). Kam shku, kam shku kështu, kam shku n’qendër të qytetit deri te Sllovenia Sporti. Te Sllovenia e Sportit janë kanë me maska. Tashi m’u laku thojsha m’thrrasin. Unë përmyes tyne edhe serbisht tu fol, “Dobro jutro”, “Dobro jutro”, edhe përmydis tyne. Qysh janë kanë qishtu {tregon me shenjë që kanë qenë afër njëri tjetrit} unë përmydis, jo anash.

Aty kur kom hypë naltë aty, u kanë Skender Hyseni në shpi aty. Se s’ka pa dalë Skender Hyseni. Ka qenë baba i vet, Ejupi. Edhe e kom pytë, “A osht’ Skenderi aty?” Ka thanë, “Po”. Jom hypë naltë, “Po shkoj deri te kryetari”, tha, “Mos shko”, “Vallahi po, pa shku nuk e lo”. Aty rrugës trup të Dubrovnikut. E kom taku, në krye të rrugës e kom taku babën e Baton Haxhiut, Fazlinë. E kom pytë se patën thanë e kanë vra. E pata pytë, “A jeni tanë a jeni?” Tha, “Po po p’e di çka po m’thu”, tha, “po mirë jemi”.

Tani kom hypë naltë atje, ku osht’ vorri tash, jom kthy majtas te shtëpija. Qaty ushtria ishin kanë. Tulilloj ushtrie n’dynje. M’kanë shti me u deshë pjesën naltë me m’kqyrë çka kom. Kryetari m’kish pa naltë atje kish thanë, “Qy ku u ardhë Elezi bre”. M’kanë majtë nja ni orë e diçka. E thashë, “Unë du me hi mrena, se unë e kom pytë dikanin këtu kur u hy, jo ju me m’pytë mua”. E kanë thirrë, kond e kanë pytë nuk di, demek, me m’lëshu. Më thanë, “E ke marrë përgjigjen negative, duhesh m’u kthy”. E qaty tani pak u frikësova thojsha tash më vrasin.

Anita Susuri: Pastaj jeni kthy...

Elez Nikçi: Veç thojsha mos t’më lojnë midis rrugë. U dufsha poshtë me ra niherë me shku te poshtë se thojshin, “Janë njësit speciale poshtë”. U kanë ajo kafja Dea. M’bërtiti, m’shajti pak, “Kthehu rrugës kah je ardhë”. Jom kthy tanshi poshtë, jom kthy në Dardani. E qishtu tanshi hajt, hajt, hajt, hajt erdh koha u lirim. Hyn forcat, filloj jeta tjetër.

Anita Susuri: Qysh ju ka dokë qajo ditë kur ka hi KFOR-i? A e keni pa ju t’u hi?

Elez Nikçi: Po, po. Në qendër të Prishtinës erdhën. S’i kuptojsha unë qato tenkat e rusve çka dojshin ato. Menojsha që janë edhe ato të NATO-s. Veç kanë hi ato gurkat, kanë hi ma s’pari, po u qujshin njësi speciale, ato gurkat angleze. Ato janë gurkat janë njësi e Nepalit. A thirrën gurka? E ata anglezët në atë kohë kur kanë sundu atë pjesën e Indisë, i kanë marrë ato formacione t’tyne edhe dita e sotit i kanë do shpata të shkurta, gurkat edhe shkojnë ato. Kanë hy ma s’pari ato gurkat.

Anita Susuri: Më tregut që keni fillu me iniciu, me ndihmu në formimin e baletit prapë mas luftës...

Elez Nikçi: Ish kolega jem tashi që nuk jeton ma, se ai edhe para luftës ka qenë shef baleti mas shkumjes së Abdurrahmon Nokshiqit, ishte në Kanadë. E kam telefonu, “Duhesh m’u kthy me ardhë me riaktivizu baletin”, sepse ishim mbledhë na, duhej diçka me bo aty edhe erdh. Erdh mas nja ni muje u kthye. U mbledhëm me të gjithë kolegët që ishim edhe morëm vendim për me shkue me lut me ni

kërkesë për me na ndihmue Drejtoria për Kulturë, për Arsim e Komunës të Prishtinës i cili ishte Zijadin Gashi, të cilit i falënderohna shumë, për me themelu ni degë të baletit krahas shkollës të muzikës. Të cilën edhe për ni kohë shumë shpejt e ka ba.

E ka thirrë ish drejtorin e atëhershëm, Ramadan Sopin, ish drejtori i shkollës të muzikës edhe kështu që u themelu dega e baletit. Tashti na shkum në audicion, unë edhe Ahmeti. Se duhej audicion m’i përzgjedhë pak a shumë. Se na e dishim çfarë parametra duhet me pasë fizikusi. Sepse duhet pak krahët me kanë, na i thojmë gjyksi i pulës, dihet kur osht’ ajo kështu që nuk mun e përmirëson. Duhej pak do pozicione të kamve, ku e di unë, edhe taktin muzikor. I kishim ni arsimtar të muzikës duhej për shembull me ia bo me gishta *tak, tak, tak* {onomotope}. Sa ka afinitet.

Kështu që i kemi përzgjedhë e u formu dega e baletit. Domethonë paraleleja e baletit t’cilën e ka udhëheqë pastaj ni periudhë e kom udhëheq unë ni gjeneratë. Tjerat nuk muja m’i çu tanë deri n’fund se do dështun. Dy i qita deri n’fund, njani s’u mor’ me balet kurrë, Frashër Krasniqi, desidenti i Vetëvendosjes. Ai e ka kry baletin edhe ka qenë shumë i mirë. Jeta Musolli tash osht’ ni prima balerinë në teatër. Pastaj gjeneratën tjetër e ka marrë Ahmeti t’cilët janë shumë, tash ai pat’ ma sukses se unë. I boni nja 15 a 16. Tani klanë vazhdu herë pas here, ajo nuk osht’ ndërpre kurrë.

Tashi nuk e di, kohën e fundit, a po ekziston ma. M’doket osht’ ni Krenare Krasniqi, motra e qitij Frashërit, e udhëheq degën e baletit pranë shkollës të muzikës. Nuk e di kuadrat çfare kanë shku ma. Qishtuqë e kemi arritë. Pastaj, ishte çashtja e financave, ishte, ishte financat ishin të përbashkëta me teatrin edhe nuk dishin kush sa po merr, çka po bon. Atëherë sekretare përmante ishte në Zana Brisku, ishte në Ministri të Kulturës, e njifsha personalisht. Shkova e lufta për me ia bo ni nën kod baletit, me pasë ni fond t’vetin. Edhe këtë ia kom mundësu trupës të baletit.

Kështu që e kom shfrytëzu qat’ rastin tem pranë presidentit që t’i ndihmoj baletit me ni rrugëtim të ri përpara. Tashti janë rritë ata djem, nuk janë ma të ri, kanë bo ni përvojë të jashtëzakonshme. Po është ma e keqja që ata sikur ne i kanë trashëgu ato t’metat shtetnore t’cilat nuk kujdesën për ni objekt, për ni sallë të ushtrimeve. Se duhet me kanë salla e ushtrimeve adekuate për baletin e ndriçune mirë, e naltë mbi pesë metra, për shkak të pastërtisë ajrit. Nuk ekziston. Po ushtrojnë, s’di ku po ushtrojnë ata djemt edhe kshtu osht’ gjyna, për gjyna.

Anita Susuri: Zoti Elez nëse veç doni edhe diçka me shtu për fund ose me tregu edhe diçka...

Elez Nikçi: Unë për fund po ju thom faleminderit shumë, pata knaqësinë me juve...

Anita Susuri: Gjithashtu!

Elez Nikçi: Ju dëshiroj punë të mbarë në të ardhmën e çdo të mirë!